



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 599/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Gani Podrimqaku, kandidat për anëtar të Kuvendin Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si i bazuar apeli i Gani Podrimqaku, kandidat për anëtar të Kuvendin Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Glllogoc, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Glllogoc nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për vendvotimin 0303e/01R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutin së votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Gani Podrimqaku, kandidat për anëtar të Kuvendin Komunal në Glllogoc, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendon se në fshatin Korreticë e Epërme në vendvotimin 0303e/01R ka shumë familjar dhe miq të cilët e kanë votuar, por në procesverbal i mungojnë votat.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

## **Apeli është i bazuar**

Paneli, me datë 11.11.2017, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 0303e/01R, është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK), kandidati nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Glllogoc, nuk ka asnjë votë në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i apelit i posedon 17 vota të vlefshme.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 599/2017 më datën 11.11.2017



*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa.*